



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-19032 /2026

Datë: 02.02 /2026

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 nën d) si dhe nenit 40.1 dhe 40.2 nën l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ, Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, si dhe nenit 40 paragrafi 1 dhe 2 nën pikën 11 të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën VI-të të rregullt për vitin 2026 të mbajtur më 26.06.2026 mori këtë:

V E N D I M

Për miratim të Planit të Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2026

1. Miratohet Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Klinës për vitin 2026.
2. Plani i punës përcakton objektivat, aktivitetet dhe prioritetet e Këshillit gjatë vitit 2026, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit institucional dhe rritjes së sigurisë në bashkësi.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Klinës për vitin 2026.
4. Plani i miratuar do të shërbejë si dokument bazë për organizimin, koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve të Këshillit gjatë periudhës së zbatimit të tij.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i Komunës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.
6. Institucionet përgjegjëse janë të obliguara të bashkëpunojnë për realizimin e aktiviteteve të parapara në Planin e Punës së KKSB-së.
7. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-284, dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



Kryesues i Kuvendit
Enver Berisha